

32002L0003

Direktiva 2002/3/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 12 shkurtit 2002 në lidhje me ozonin në ajrin e mjedisit

Gazeta Zyrtare L 067, 09/03/2002 fq. 0014 - 0030

Direktiva 2002/3/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 12 shkurtit 2002 në lidhje me ozonin në ajrin e mjedisit

PARLAMENTI EVROPIAN DHE KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin Themelues të Komunitetit Evropian dhe në veçanti nenin 175(1) të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit¹,

Duke pasur parasysh mendimin e Komitetit Ekonomik dhe Social²,

Duke pasur parasysh mendimin e Komitetit të Rajoneve³,

Duke vepruar në përputhje me procedurën e parashtruar në nenin 251 të Traktatit⁴, duke marrë në konsideratë tekstin e përbashkët të miratuar nga Komiteti i Pajimit, më 10 dhjetor 2001,

Duke pasur parasysh se:

(1) Mbi bazën e parimeve të mishëruara në nenin 174 të Traktatit, Programi i Pestë i Veprimit Mjedisor i miratuar nga Rezoluta e Këshillit dhe e Përfaqësuesve të Qeverive të Shteteve Anëtare që takohen brenda Këshillit e 1 shkurtit 1993 në lidhje me programin e politikës dhe veprimit të Komunitetit Evropian mbi mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm⁵ dhe plotësuar nga Vendimi nr. 2179/98/KE⁶, parashikon veçanërisht ndryshime në legjislacionin ekzistues mbi ndotësit e ajrit. Programi i mësipërm këshillon krijimin e objektivave afatgjata të cilësisë së ajrit.

(2) Sipas nenit 4 pika (5) të Direktivës së Këshillit 96/62/KE të 27 shtatorit 1996 mbi vlerësimin dhe menaxhimin e cilësisë së ajrit të mjedisit⁷, Këshilli duhet të miratojë legjislacionin e parashikuar në paragrafin 1 dhe dispozitat e përcaktuara në paragrafët 3 dhe 4 të atij neni.

¹ GZ C 56 E, 29.2.2000, fq. 40, dhe GZ C 29 E, 30.1.2001, fq. 291.

² GZ C 51, 23.2.2000, fq. 11.

³ GZ C 317, 6.11.2000, fq. 35.

⁴ Mendimi i Parlamentit Evropian i 15 marsit 2000 (GZ C 377, 29.12.2000, fq. 154), Pozicioni i Përbashkët i Këshillit i 8 marsit 2001 (GZ C 126, 26.4.2001, fq. 1) dhe Vendimi i Parlamentit Evropian i 13 qershorit 2001 (ende i pabotuar në Gazetën Zyrtare). Vendimi i Parlamentit Evropian i datës 17 janar 2002 dhe Vendimi i Këshillit i datës 19 dhjetor 2001.

⁵ GZ C 138, 17.5.1993, fq. 1.

⁶ GZ L 275, 10.10.1998, fq. 1.

⁷ GZ L 296, 21.11.1996, fq. 55.

(3) Është e rëndësishme të sigurohet mbrojtja efektive kundër pasojave të dëmshme mbi shëndetin e ekspozimit të njeriut ndaj ozonit. Pasojat negative mbi bimësinë, ekosistemet dhe mjedisin në tërësi, duhet të zvogëlohen sa më shumë që të jetë e mundur. Natyra ndërkuftare e ndotjes së ozonit kërkon masa të marra në nivel Komuniteti.

(4) Direktiva 96/62/KE parashikon që pragjet numerike të bazohen në rezultatet e punës së kryer nga grupet ndërkombëtare shkencore që janë aktive në këtë fushë. Komisioni duhet të marrë parasysh të dhënat kërkimore shkencore më të fundit në fushat përkatëse epidemiologjike dhe mjedisore, si dhe përparimet më të fundit në metrologji, me synim rishqyrtimin e elementëve në të cilët janë bazuar këto pragje.

(5) Direktiva 96/62/KE kërkon që vlerat kufi dhe/ose vlerat e synuara të përcaktohen për ozonin. Duke marrë parasysh natyrën ndërkuftare të ndotjes së ozonit, vlerat e synuara duhet të përcaktohen në nivel Komuniteti për mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe mbrojtjen e bimësisë. Këto vlera të synuara duhet të lidhen me objektivat e përkohshme që lindin nga strategjia e integruar e Komunitetit për luftimin e acidimit dhe ozonit në nivelin e tokës, që gjithashtu formon bazën e Direktivës 2001/81/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 23 tetorit 2001 mbi tavanet e emetimeve kombëtare për disa ndotës atmosferikë⁸.

(6) Në përputhje me Direktivën 96/62/KE, duhet të zbatohen plane dhe programe në lidhje me zonat dhe grumbullimet brenda të cilave përqendrimet e ozonit tejkalojnë vlerat e synuara, me qëllim që të sigurohen që vlerat e synuara të jenë përmbushur në nivelin më të lartë të mundshëm deri në datën e përcaktuar. Këto plane dhe programe duhet t'u referohen, në një shkallë të konsiderueshme, masave të kontrollit që duhet të zbatohen në përputhje me legjislacionin përkatës të Komunitetit.

(7) Objektivat afatgjatë duhet të përcaktohen me synim sigurimin e mbrojtjes efektive të shëndetit të njeriut dhe mjedisit. Objektivat afatgjatë duhet të lidhen me strategjinë e ozonit dhe zvogëlimin të acidimit dhe qëllimi i tyre është sheshimi i barrierave midis niveleve aktuale të ozonit dhe objektiveve afatgjata.

(8) Masat duhet të jenë të detyrueshme në zonat me tejkalim të objektivave afatgjatë. Mjetet plotësuese të vlerësimit mund të ulin numrin e kërkuar të pikave fikse të përzgjedhjes së mostrave.

(9) Duhet të përcaktohet një prag sinjalizues për ozonin për mbrojtjen e popullsisë së përgjithshme. Duhet të përcaktohet një prag informacioni për mbrojtjen e seksioneve më të brishtë të popullsisë. Publikut duhet t'i vihet në dispozicion informacioni i rregullt, i përditësuar, në lidhje me përqendrimet e ozonit në ajrin e mjedisit.

(10) Duhet të hartohen plane veprimi afatshkurtër, ku rreziku i tejkalimit të pragut

⁸ GZ L 309, 27.11.2001, fq. 22

sinjalizues mund të ulet në mënyrë të ndjeshme. Mundësia e uljes së rrezikut, kohëzgjatja dhe shkalla e tejkalimit duhet t'i nënshtrohet kërkit dhe vlerësimit. Nuk duhet të kërkoen masa në nivel lokal, kur shqyrtimi i fitimeve dhe shpenzimeve tregon se ato nuk janë të përpjesëtueshme.

(11) Natyra ndërkufitare e ndotjes së ozonit mund të kërkojë bashkërendimin midis Shteteve Anëtare në hartimin dhe zbatimin e planeve, programeve dhe planeve të veprimit afatshkurtër dhe në informimin e publikut. Në raste të përshtatshme, Shtetet Anëtare duhet të ndjekin bashkëpunimin me vendet e treta, duke i kushtuar vëmendje të veçantë përfshirjes së hershme të vendeve candidate për anëtarësim.

(12) Si bazë për raportet e rregullta, informacioni mbi përqendrimet e matura duhet t'i paraqitet Komisionit.

(13) Komisioni duhet të rishikojë dispozitat e kësaj Direktive duke marrë parasysh kërkimin më të fundit shkencor, veçanërisht në lidhje me pasojat e ozonit mbi shëndetin e njeriut dhe mjedisin. Raporti i Komisionit duhet të paraqitet si pjesë përbërëse e një strategjie mbi cilësinë e ajrit, e hartuar për rishikimin dhe propozimin e objektivave të cilësisë së ajrit në nivel Komuniteti dhe zhvillimin e strategjive zbatuese për të siguruar arritjen e atyre objektivave. Në këtë kontekst, raporti duhet të marrë në konsideratë mundësinë e arritjes së objektivave afatgjatë brenda një periudhe kohore të përcaktuar.

(14) Masat e nevojshme për zbatimin e kësaj Direktive duhet të miratohen në përputhje me Vendimin e Këshillit 1999/468/KE të 28 qershorit 1999 që përcakton procedurat për ushtrimin e kompetencave zbatuese të dhëna Komisionit⁹.

(15) Meqë objektivat e veprimit të propozuar që siguron mbrojtje efektive kundër pasojave të dëmshme mbi shëndetin e njeriut nga ozoni dhe zvogëlimin e efektit negativ të ozonit në bimësi, ekosisteme dhe mjedisin në tërësi, nuk mund të arrihen në nivel të mjaftueshëm nga Shtetet Anëtare për shkak të natyrës ndërkufitare të ndotjes së ozonit dhe prandaj mund të arrihen më mirë në nivel Komuniteti, ky i fundit mund të miratojë masa në përputhje me parimin e subsidiaritetit, siç përcaktohet në nenin 5 të Traktatit. Në përputhje me parimin e përpjesëtueshmërisë, siç përcaktohet në atë nen, kjo Direktivë nuk shkon përtej asaj çfarë nevojitet për arritjen e qëllimit të atyre objektivave.

(16) Direktiva e Këshillit 92/72/KEE e 21 shtatorit 1992 mbi ndotjen e ajrit nga ozoni¹⁰ duhet të shfuqizohet

KANË MIRATUAR KËTË DIREKTIVË

Neni 1

Qëllimet

⁹ GZ L 184, 17.7.1999, fq. 23

¹⁰ GZ L 297, 13.10.1992, fq. 1

Qëllimi i kësaj Direktive është:

- (a) Krijimi i objektivave afatgjata, vlerave të synuara, një pragu sinjalizimi për përqendrimet e ozonit në ajrin e mjedisit në Komunitet, projektuar për mënjanimin, parandalimin ose zvogëlimin e pasojave të dëmshme mbi shëndetin e njeriut dhe mjedisin në tërësi;
- (b) Përdorimi i metodave dhe kriterëve të përbashkëta për vlerësimin e përqendrimeve të ozonit dhe, sipas rastit, lëndëve në lidhje me ozonin (oksidet e nitrogenit dhe përbërësit organikë të avullueshëm) në ajrin e mjedisit në Shtetet Anëtare;
- (c) Marrja e informacionit të mjaftueshëm në nivelet e mjedisit të ozonit dhe mundësimi i këtij informacioni për publikun;
- (d) të sigurohet që për sa i përket ozonit, të ruhet cilësia e ajrit të mjedisit kur është e mirë dhe të përmirësohet në raste të tjera;
- (e) Nxitja dhe zhvillimi i bashkëpunimit ndërmjet Shteteve Anëtare për uljen e niveleve të ozonit, përdorimit të potencialit të masave ndërkufitare dhe marrëveshjes mbi këto masa.

Neni 2

Përkufizime

Për qëllimet e kësaj Direktive:

1. 'ajri i mjedisit' nënkupton ajrin e mjediseve të hapura në troposferë, duke përjashtuar vendet e punës;
2. 'ndotës' nënkupton çdo substancë të prezantuar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo nga njerëzit në ajrin e mjedisit dhe që ka të ngjarë të ketë pasoja të dëmshme mbi shëndetin e njeriut dhe/ose mjedisin në tërësi;
3. 'substancë që shkaktojnë ozon' nënkupton substancat që ndihmojnë në formimin e ozonit në nivelin e tokës dhe disa prej tyre renditen në Shtojcën VI;
4. 'nivel' nënkupton përqendrimin e një ndotësi në ajrin e mjedisit ose depozitimin e tij në sipërfaqe në një kohë të caktuar;
5. 'vlerësim' nënkupton çdo metodë të përdorur për matjen, llogaritjen, parashikimin ose vlerësimin e nivelit të një ndotësi në ajrin e mjedisit;
6. 'matje fikse' nënkupton matjet e bëra në përputhje me nenin 6(5) të Direktivës 96/62/KE;
7. 'zonë' nënkupton pjesë të territorit të një Shteti Anëtar, siç përcaktohen kufijtë nga ai;
8. 'grumbullim' nënkupton një zonë me përqendrim popullsie prej më tepër se 250 000 banorë ose, kur përqendrimi i popullsisë është 250 000 banorë ose më pak, një dendësi popullsie për km² që për Shtetin Anëtar shfaqëson nevojën për vlerësimin dhe menaxhimin e cilësisë së ajrit të mjedisit;
9. 'vlerë e synuar' nënkupton një nivel fiks, me synim në planin afatgjatë të mënjanimit të pasojave të dëmshme mbi shëndetin e njeriut dhe/ose mjedisit në tërësi, që duhet të arrihen sipas mundësisë gjatë një periudhe të caktuar;
10. 'objektiv afatgjatë' nënkupton një përqendrim ozoni në ajrin e mjedisit poshtë të cilit, sipas dijes aktuale shkencore, efektet e drejtpërdrejta negative mbi shëndetin e

njeriut dhe/ose mjedisin në tërësi nuk janë të mundshme. Ky objektivi duhet të arrihet në planin afatgjatë, përveç rasteve kur nuk është i arritshëm, nëpërmjet masave të përpjesëtueshme, me synim sigurimin e mbrojtjes efektive të shëndetit të njeriut dhe mjedisit;

11. 'prag sinjalizues' nënkupton një nivel përtej të cilit ekziston rreziku ndaj shëndetit të njeriut nga ekspozimi i shkurtër për popullsinë e përgjithshme dhe për të cilin duhet të merren masa të menjëhershme nga Shtetet Anëtare, siç përcaktohet në nenet 6 dhe 7;

12. 'pragu i informacionit' nënkupton një nivel përtej të cilit ekziston rreziku ndaj shëndetit të njeriut nga ekspozimi i shkurtër për seksione tepër të ndjeshëm të popullsisë dhe për të cilin është i nevojshëm informacioni i përditësuar;

13. 'përbërësit organikë të avullueshëm' (VOC) nënkuptojnë të gjithë përbërësit organikë nga burimet antropogjene dhe biogjenike, të ndryshme nga metani, që janë në gjendje të prodhojnë oksidantë fotokimikë nga reaksionet me oksidet e nitrogjenit/azotit në praninë e dritës së diellit.

Neni 3

Vlerat e synuara

1. Vlerat e synuara për vitin 2010 në lidhje me përqendrimet e ozonit në ajrin e mjedisit janë ato të përcaktuara në Seksionin II të Shtojcës I.

2. Shtetet Anëtare përpilojnë një listë të zonave dhe grumbullimeve në të cilat nivelet e ozonit në ajrin e mjedisit, siç vlerësohen në përputhje me nenin 9, janë më të larta se vlerat e shenjësuar të referuara në paragrafin 1.

3. Për zonat dhe qendrat urbane të përcaktuara në paragrafin 2, Shtetet Anëtare marrin masa që në përputhje me dispozitat e Direktivës 2001/81/KE të sigurojnë përgatitjen dhe zbatimin e një plani ose programi me qëllim arritjen e vlerës së synuar nga data e përcaktuar në Seksionin II të Shtojcës I, me përjashtim të rasteve kur kjo nuk mund të arrihet përmes masave të përpjesëtueshme.

Kur në përputhje me nenin 8 pika (3) të Direktivës 96/62/KE, duhet të përgatiten dhe zbatohen plane ose programe në lidhje me ndotës të tjerë përveç ozonit, Shtetet Anëtare, nëse është e përshtatshme, do të përgatisin dhe zbatojnë plane ose programe të integruara që mbulojnë të gjithë ndotësit në fjalë.

4. Planet ose programet e përcaktuara në paragrafin 3 duhet të përfshijnë të paktën informacionin e listuar në Shtojcën IV të Direktivës 96/62/KE dhe duhet të vihen në dispozicion të publikut dhe të organizatave relevante të tilla si organizatat për mbrojtjen e mjedisit, organizatat për mbrojtjen e konsumatorit, organizatave që përfaqësojnë interesat e grupeve të ndjeshme të popullsisë dhe organeve të tjera relevante të kujdesit shëndetësor.

Neni 4

Objektivat afatgjata

1. Objektivat afatgjata për përqendrimet e ozonit në ajrin e mjedisit janë ato që

përcaktohen në Seksionin III të Shtojcës I.

2. Shtetet Anëtare hartojnë një listë të zonave dhe qendrave urbane në të cilat nivelet e ozonit në ajrin e mjedisit, siç vlerësohet në përputhje me nenin 9, janë më të larta se objektivat afatgjata të referuara në paragrafin 1, më poshtë ose të barabarta me vlerat kufi të përcaktuara në Seksionin II të Shtojcës I. Për këto zona dhe qendra urbane, Shtetet Anëtare përgatisin dhe zbatojnë masa racionale, me synim arritjen e objektivave afatgjata. Masat e marra, të paktën, duhet të jenë në përputhje me të gjitha planet ose programet e veçanta në nenin 3 pika (3). Për më tepër, ata marrin masa sipas dispozitave të Direktivës 2001/81/KE dhe legjislacionit tjetër ekzistues dhe të ardhshëm të KE.

3. Progresi i komunitetit drejt arritjes së objektivave afatgjata i nënshtrohet rishikimeve pasuese, si pjesë të procesit të parashtruar në nenin 11 dhe në lidhje me Direktivën 2001/81/KE, duke përdorur vitin 2020 si standard dhe duke marrë parasysh progresin drejt arritjes së taveve kombëtare të emetimeve të përcaktuara në Direktivën e mësipërme.

Neni 5

Kërkesat në zonat dhe grumbullimet ku nivelet e ozonit arrijnë objektivat afatgjata, Shtetet Anëtare përpilojnë një listë të zonave dhe grumbullimeve në të cilat nivelet e ozonit arrijnë objektivat afatgjata. Në shkallën e lejueshme nga faktorët që përfshijnë natyrën ndërkufitare të ndotjes së ozonit dhe kushteve meteorologjike, ato ruajnë nivelet e ozonit në ato zona dhe grumbullime poshtë objektivave afatgjata dhe ruajnë përmes masave të përpjesëtueshme cilësinë më të mirë të ajrit të mjedisit, të pajtueshme me zhvillimin e qëndrueshëm dhe një nivel të lartë të mbrojtjes së shëndetit të njeriut dhe mbrojtjes mjedisore.

Neni 6

Informacioni për publikun

1. Shtetet Anëtare marrin masa të përshtatshme për të:

(a) siguruar vënien në dispozicion të publikut të informacionit të rregullt, të përditësuar në lidhje me përqendrimet e ozonit në ajrin e mjedisit, si dhe ndaj organizatave përkatëse si: organizatave mjedisore, organizatave të konsumatorëve, organizatave që përfaqësojnë interesat e grupeve më të prekshme të popullsisë dhe organeve të tjera përkatëse të kujdesit shëndetësor.

Ky informacion përditësohet të paktën çdo ditë dhe sa herë që është e zbatueshme ose në raste të përshtatshme, përditësohet mbi bazë orësh.

Ky informacion tregon të paktën të gjitha tejkallimet e përqendrimeve në objektivin afatgjatë për mbrojtjen e shëndetit, pragun e informacionit dhe pragun e sinjalizimit për periudhën përkatëse të nivelit mesatar. Ai gjithashtu duhet të parashikojë një vlerësim të shkurtër në lidhje me pasojat mbi shëndetin.

Pragu i informacionit dhe pragu i sinjalizimit për përqendrimet e ozonit në ajrin e mjedisit jepen në Seksionin I të Shtojcës II;

(b) Për t'i mundësuar publikut dhe organizatave të përshtatshme si : organizatave

mjedisore, organizatave të konsumatorëve, organizatave që përfaqësojnë interesat e grupeve më të prekshme të popullsisë dhe organeve të tjera përkatëse të kujdesit shëndetësor, raporte gjithëpërfshirëse vjetore ku të paktën tregojnë në rastin e shëndetit të njeriut të gjitha tejkalimet e përqendrimeve në vlerën e synuar dhe objektivin afatgjatë, pragun e informacionit dhe pragun e sinjalizimit për periudhën përkatëse të nivelit mesatar, dhe në rast të bimësisë, çdo tejkalim të vlerës së synuar dhe objektivit afatgjatë të kombinuar sipas rastit me një vlerësim të shkurtër të efekteve të këtyre tejkalimeve. Ato mund të përfshijnë sipas rastit informacion të mëtejshëm dhe vlerësime mbi mbrojtjen e pyjeve, siç specifikohet në seksionin I të Shtojcës III. Kjo gjithashtu mund të përfshijë informacion mbi substancat përkatëse që ndihmojnë në formimin e ozonit, për sa kohë që ato nuk mbulohen nga legjislacioni ekzistues i Komunitetit;

(c) Për të siguruar dhënien në kohë institucioneve të kujdesit shëndetësor dhe popullsisë, të informacionit në lidhje me tejkalimet aktuale ose të parashikuara të pragjeve të sinjalizimit.

Informacioni dhe raportet e referuara më lart publikohen me mjete të përshtatshme, në varësi të rastit përkatës, për shembull: me anë të transmetimit në media, shtyp ose botime, ekrane informative ose shërbime rrjetesh kompjuterike si interneti.

2. Hollësitë e dhëna publikut në përputhje me nenin 10 të Direktivës 96/62/KE kur çdo prag tejkalohe, përfshijnë zërat e listuar në Seksionin II të Shtojcës II. Kur është e zbatueshme, Shtetet Anëtare gjithashtu marrin masa për dhënien e këtij informacioni, kur parashikohet një tejkalim i pragut të informacionit ose pragut të sinjalizimit.

3. Informacioni i dhënë sipas paragrafëve 1 dhe 2 do të jetë i qartë, i kuptueshëm dhe i disponueshëm.

Neni 7

Planet e veprimit afatshkurtër

1. Në përputhje me nenin 7 pika (3) të Direktivës 96/62/KE, Shtetet Anëtare hartojnë plane veprimi në nivele të përshtatshme administrative, duke treguar masa të veçanta që duhen marrë në planin afatshkurtër, duke marrë parasysh, rrethana të veçanta lokale për zonat ku ka rrezik të tejkalimeve të pragut të sinjalizimit nëse ka një mundësi të konsiderueshme për uljen e atij rrezikut ose për uljen e kohëzgjatjes ose shkallës së tejkalimit të pragut të sinjalizimit. Kur konstatohet që nuk ekziston ndonjë potencial i konsiderueshëm për uljen e rrezikut, kohëzgjatjen ose shkallën e çdo tejkalimi në zonat përkatëse, Shtetet Anëtare përjashtohen nga dispozitat e nenit 7 pika (3) të Direktivës 96/62/KE. Shtetet Anëtare duhet të identifikojnë nëse ka ndonjë potencial të konsiderueshëm për uljen e rrezikut, kohëzgjatjes ose shkallës së çdo tejkalimi, duke marrë parasysh kushtet gjeografike, meteorologjike dhe ekonomike.

2. Hartimi i planeve të veprimit afatshkurtër, duke përfshirë krijimin e niveleve për veprime të veçanta, është përgjegjësia e Shteteve Anëtare. Në varësi të rasteve individuale, planet mund të parashikojnë masa racionale të shkallëzuara, për të kontrolluar dhe nëse lind nevoja, për të ulur ose pezulluar disa aktivitete, duke përfshirë trafikun e automjeteve që kontribuojnë në emetime të cilat rezultojnë në

tejkalimin e pragut të sinjalizimit. Këto gjithashtu mund të përfshijnë masa efektive në lidhje me përdorimin e bimëve ose produkteve industriale.

3. Nën zhvillimin dhe zbatimin e planeve të veprimit afatshkurtër, Shtetet Anëtare marrin në konsideratë shembujt e masave (efektiviteti i të cilave është vlerësuar) që duhet të përfshihen në udhëzimin e referuar në nenin 12.

4. Shtetet Anëtare vënë në dispozicion të publikut dhe organizatave të përshtatshme si organizatave mjedisore, organizatave të konsumatorëve, organizatave që përfaqësojnë interesat e grupeve më të prekshme të popullsisë dhe organeve të tjera përkatëse të kujdesit shëndetësor, si rezultatet e hetimeve të tyre, dhe përmbajtjen e planeve të veçanta të veprimit afatshkurtër, si dhe informacionin në lidhje me zbatimin e këtyre planeve.

Neni 8

Ndotja ndërkufitare

1. Kur përqendrimet e ozonit që tejkalojnë vlerat e synuara ose objektivat afatgjata janë kryesisht për shkak të emetimeve të substancave të cilat ndihmojnë në formimin e ozonit në Shtete të tjera Anëtare, Shtetet Anëtare të interesuara bashkëpunojnë sipas rastit në hartimin e planeve dhe programeve të përbashkëta, me qëllim arritjen e vlerave të synuara ose objektivave afatgjata, kur këto nuk janë arritur nëpërmjet masave të përpjesëtueshme. Komisioni jep ndihmesën e tij në këto përpjekje. Në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas nenit 11, Komisioni shqyrton, duke marrë në konsideratë Direktivën 2001/81/KE, veçanërisht nenin 9 të saj, nëse duhet të merren masa të mëtejshme në nivel Komuniteti, me synim uljen e emetimeve të substancave përgjegjëse që ndihmojnë në formimin e ozonit për këtë ndotje ndërkufitare ozoni.

2. Sipas rastit dhe në përputhje me nenin 7, Shtetet Anëtare përgatisin dhe zbatojnë plane të përbashkëta veprimi afatshkurtër që mbulojnë zonat fqinje në Shtete të ndryshme Anëtare. Shtetet Anëtare sigurojnë që zonat fqinje në Shtete të ndryshme Anëtare të cilat kanë zhvilluar plane afatshkurtra veprimi, të marrin të gjithë informacionin e përshtatshëm.

3. Kur tejkalimet e pragut të informacionit ose pragut të sinjalizimit ndodhin në zonat afër kufijve kombëtarë, autoriteteve kompetente në Shtetet Anëtare të interesuara duhet t'u jepet informacion në një kohë sa më të shpejtë, me qëllim lehtësimin e sigurimit të informacionit për publikun në ato Shtete.

4. Në hartimin e planeve dhe programeve të referuara në paragrafin 1 dhe 2 dhe në informimin e publikut, siç referohet në paragrafin 3, Shtetet Anëtare, sipas rastit, ndjekin bashkëpunimin me vendet e treta, duke i kushtuar vëmendje të veçantë vendeve kandidatë për anëtarësim.

Neni 9

Vlerësimi i përqendrimeve të ozonit dhe substancave paraardhëse në ajrin e mjedisit

1. Në zonat dhe grumbullimet ku gjatë ndonjë prej pesë viteve të mëparshme të matjes, përqendrimet e ozonit e kanë tejkalluar objektivin afatgjatë, matja e

vazhdueshme fikse është e detyrueshme.

Kur vihen në gatishmëri të dhëna, të më pak se pesë viteve, Shtetet Anëtare mund të vendosin tejkalime, fushata masash të ndërthurura me kohëzgjatje të shkurtër në kohë dhe vendndodhje që kanë të ngjarë të jenë tipike me nivelet më të larta të ndotjes, të përfuara nga inventarët dhe modelimi i emetimeve.

Shtojca IV parashtron kriteret për përcaktimin e vendndodhjes së pikave të përzgjedhjes së mostrave për matjen e ozonit.

Seksioni I i Shtojcës V përcakton numrin minimal të pikave të përzgjedhjes së mostrave për matjen e vazhdueshme të ozonit në secilën zonë ose grumbullim brenda të cilit matja është burimi i vetëm i informacionit për vlerësimin e cilësisë së ajrit.

Matjet e dyoksidit të azotit bëhen gjithashtu në nivelin minimal prej 50 % të pikave të përzgjedhjes së mostrave të ozonit të kërkuara nga Seksioni I i Shtojcës V. Matjet e dyoksidit të azotit do të jenë të vazhdueshme, me përjashtim të stacioneve me prejardhje rurale, siç përcaktohen në seksionin I të Shtojcës IV, ku mund të përdoren metodat e matjeve.

Për zonat dhe grumbullimet brenda të cilave informacioni nga pikat e përzgjedhjes së mostrave për matjet fikse plotësohet me informacion nga modelimi dhe/ose matjet treguese, numri total i pikave të përzgjedhjes së mostrave të veçanta në Seksionin I të Shtojcës V mund të ulen, me kusht që:

- (a) metodat plotësuese sigurojnë një nivel të mjaftueshëm informacioni për vlerësimin e cilësisë së ajrit në lidhje me vlerat e synuara, informacionin dhe pragjet sinjalizuese;
- (b) numri i pikave të përzgjedhjes së mostrave dhe rezolucioni hapësinor i teknikave të tjera të jenë të mjaftueshme për përqendrimin e ozonit që duhet caktuar në përputhje me objektivat e cilësisë së të dhënave të veçanta në Seksionin I të Shtojcës VII dhe çon në rezultatet e vlerësimit siç specifikohen në Seksionin II të Shtojcës VII;
- (c) numri i pikave të përzgjedhjes së mostrave në secilën zonë ose grumbullim arrin në të paktën një pikë përzgjedhjeje mostrash për dy milion banorë ose një pikë përzgjedhjeje mostrash për 50 000 km², cilado që sjell numrin më të madh të pikave të përzgjedhjes së mostrave;
- (d) çdo zonë ose grumbullim përmban të paktën një pikë përzgjedhjeje të mostrave, dhe
- (e) dyoksidi i azotit matet në të gjitha pikat që mbeten të përzgjedhjes së mostrave, me përjashtim të stacioneve me origjinë rurale.

Në këtë rast, rezultatet e modelimit dhe/ose matjes treguese merren parasysh për vlerësimin e cilësisë së ajrit në lidhje me vlerat e synuara.

2. Në zonat dhe grumbullimet ku, gjatë secilit prej pesë viteve të mëparshme, përqendrimet janë poshtë objektivave afatgjata, numri i stacioneve të matjes së vazhdueshme përcaktohet në përputhje me Seksionin II të Shtojcës V.

3. Çdo Shtet Anëtar siguron që të paktën një stacion matjeje për sigurimin e të dhënave mbi përqendrimet e substancave që ndihmojnë në formimin e ozonit, të listuara në Shtojcën VI të instalohet dhe operohet në territorin e tij. Çdo Shtet Anëtar zgjedh numrin dhe vendndodhjen e stacioneve në të cilat maten substancat që ndihmojnë në formimin e ozonit, duke marrë në konsideratë objektivat, metodat dhe rekomandimet e parashtruara në Shtojcën e lartpërmendur.

Si pjesë të udhëzimit të zhvilluar sipas nenit 12, përcaktohen udhëzimet për një strategji të përshtatshme për matjen e substancave që ndihmojnë në formimin e

ozonit, duke marrë parasysh kërkesat ekzistuese në legjislacionin Komunitar dhe programin bashkëpunues për vëzhgimin dhe vlerësimin e transmetimit në rreze të largët të ndotësve të ajrit në Evropë (EMEP).

4. Metodatat e referencës të analizës së ozonit përcaktohen në Seksionin I të Shtojcës VIII. Seksioni II i Shtojcës VIII parashikon teknika referuese modelimi për ozonin.

5. Çdo ndryshim i nevojshëm për përshtatjen e këtij neni dhe Shtojcave IV deri në VIII ndaj progresit shkencor dhe teknik miratohet në përputhje me procedurën e parashtruar në nenin 13 pika (2).

Neni 10

Transmetimi i informacionit dhe raporteve

1. Në përcjelljen e informacionit për Komisionin sipas nenit 11 të Direktivës 96/62/KE, Shtetet Anëtare gjithashtu, për herë të parë për vitin kalendarik pas datës së referuar në Nenin 15 pika (1):

(a) i dërgon Komisionit për çdo vit kalendarik jo më vonë se data 30 shtator të vitit pasardhës, listat e zonave dhe grumbullimeve të referuara në Nenin 3 pika (2), Nenin 4 pika (2) dhe Nenin 5;

(b) i dërgon Komisionit një raport duke dhënë një rishikim të përgjithshëm të situatës për sa i përket tejkalimit të vlerave të synuara siç parashtrihen në seksionin II të Shtojcës I. Ky raport jep një shpjegim të tejkalimeve vjetore të vlerës së synuar për mbrojtjen e shëndetit të njeriut. Raporti gjithashtu përmban plane dhe programe të referuara në Nenin 3 pika (3). Raporti dërgohet jo më vonë se dy vjet pas mbarimit të periudhës gjatë të cilës janë vëzhguar tejkalimet e vlerave të synuara për ozonin;

(c) informojë Komisionin çdo tre vjet në lidhje me progresin e çdo plani ose programi.

2. Për më tepër, Shtetet Anëtare, për herë të parë për vitin kalendarik pas datës së referuar në nenin 15 pika (1):

(a) i dërgon Komisionit përkohësisht, për çdo vit nga muaji prill deri në shtator,

(i) jo më vonë se mbarimi i periudhës së mëpasshme, për çdo ditë me tejkalimin (tejkalimet) e informacionit dhe/ose pragut sinjalizues, informacionin e mëposhtëm: datën, orët totale të tejkalimit, maksimumi 1 h vlerë/a ozoni,

(ii) jo më vonë se data 31 tetor çdo vit, çdo informacion tjetër të specifikuar në Shtojcën III;

(b) për çdo vit kalendarik, jo më vonë se data 30 shtator të vitit pasardhës, i dërgon Komisionit informacionin e vlefshëm të specifikuar në Shtojcën III dhe përqendrimet mesatare vjetore për atë vit të substancave të cilat ndihmojnë në formimin e ozonit, të specifikuara në Shtojcën VI;

(c) t'i përcjellë Komisionit çdo tre vjet, brenda kuadrit të raportit sektorial të referuar në nenin 4 të Direktivës së Këshillit 91/692/KEE¹¹, dhe jo më vonë se data 30 shtator, pas mbarimit të çdo periudhe tre vjeçare:

(i) informacionin që rishikon nivelet e ozonit të vëzhguar ose të vlerësuar, sipas nevojës në zonat dhe grumbullimet e referuara në nenin 3 pika (2), nenin 4 pika (2)

¹¹ GZ L 377, 31.12.1991, fq. 48.

dhe nenin 5,;

(ii) informacion në lidhje me masat e marra ose të planifikuara sipas nenit 4 pika (2), dhe

(iii) informacionin në lidhje me vendimet mbi planet afatshkurtra të veprimit dhe hartimin dhe përmbajtjen, si dhe një vlerësim të efekteve të ndonjë prej këtyre planeve të përgatitura në përputhje me nenin 7.

3. Komisioni:

(a) siguron që informacioni i paraqitur sipas paragrafit 2 pika (a) të vihet menjëherë në dispozicion me anë të mjeteve të përshtatshme dhe t'i transmetohet Agjencisë Mjedisore Evropiane;

(b) publikon çdo vit një listë të zonave dhe grumbullimeve të paraqitura sipas paragrafit 1 pika (a) dhe, deri në datën 30 nëntor çdo vit, një raport mbi situatën e ozonit gjatë verës aktuale dhe vitit të mëparshëm kalendarik, duke synuar në dhënien e gjendjes së përgjithshme, në format të krahasueshëm, të situatës së çdo Shteti Anëtar, duke marrë parasysh kushtet e ndryshme meteorologjike dhe ndotjen ndërkufitare dhe një rishikim të përgjithshëm të të gjitha tejkalimeve të objektivit afatgjatë në Shtetet Anëtare;

(c) kontrollojë rregullisht zbatimin e planeve ose programeve të paraqitura sipas paragrafit 1 pika (b) duke shqyrtuar ecurinë e tyre dhe tendencat në ndotjen e ajrit, duke marrë parasysh kushtet meteorologjike dhe origjinën e substancave të cilat ndihmojnë në formimin e ozonit (biogjene ose antropogjene);

(d) marrë parasysh informacionin e dhënë sipas paragrafëve 1 dhe 2 në përgatitjen e raporteve tre vjeçare mbi cilësinë e ajrit të mjedisit në përputhje me nenin 11 pika (2) të Direktivës 96/62/KE;

(e) rregullojë shkëmbimin e informacionit të përshtatshëm dhe përvojën e paraqitur në përputhje me paragrafin 2 pika (c)(iii) në lidhje me hartimin dhe zbatimin e planeve afatshkurtra të veprimit.

4. Në kryerjen e detyrave të referuara në paragrafin 3, sipas nevojës, Komisioni i referohet ekspertizës në dispozicion të Agjencisë Mjedisore Evropiane.

5. Data deri në të cilën Shtetet Anëtare informojnë Komisionin në lidhje me metodat e përdorura për vlerësimin paraprak të cilësisë së ajrit sipas nenit 11 pika (1)(d) të Direktivës

96/62/KE, nuk do të jetë më vonë se 9 shtatori 2003.

Neni 11

Rishikimi dhe raportimi

1. Komisioni i paraqet Parlamentit Evropian dhe Këshillit deri e shumta, më 31 dhjetor 2004, një raport bazuar në përvojën e zbatimit të kësaj Direktive. Ai raporton veçanërisht në lidhje me:

(a) rezultatet e kërkimit më të fundit shkencor, duke marrë në konsideratë Udhëzimet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë, mbi pasojat e ekspozimit ndaj ozonit në mjedis dhe në shëndetin e njeriut, veçanërisht duke marrë parasysh grupet e prekshme të popullsisë; zhvillimi i modeleve më të sakta do të mbahet në konsideratë;

(b) zhvillimet teknologjike, duke përfshirë progresin e arritur në metodat e matjes dhe

vlerësimit në forma të tjera të përqendrimeve dhe evolucionin e përqendrimeve të ozonit në të gjithë Evropën;

(c) krahasimi i parashikimeve të modeleve me matjet aktuale;

(d) vendosjen e objektivave afatgjata dhe niveleve të tyre, për vlerat e synuara, për pragjet e informimit dhe sinjalizimit;

(e) rezultatet, mbi pasojat e ozonit mbi të korrat dhe bimësinë natyrore, të Programit Bashkëpunues Ndërkombëtar sipas Konventës së OKB mbi Ndotjen e Ajrit Ndërkufitar në Rreze të Largët ECE.

2. Raporti paraqitet si pjesë përbërëse e strategjisë së cilësisë së ajrit, të hartuar për të rishikuar dhe propozuar objektivat e cilësisë së ajrit në Komunitet, për të zhvilluar strategjitë zbatuese për sigurimin e arritjes së atyre objektivave. Në këtë kontekst, raporti merr parasysh:

(a) fushën e gjerë të veprimit për zhvillimin e zvogëlimeve të mëtejshme të emetimeve ndotëse nga të gjitha burimet përkatëse, duke marrë në vëmendje fizibilitetin teknik dhe nacionalitetin ekonomik,

(b) marrëdhëniet midis lëndëve ndotëse të ndryshme si dhe mundësitë për strategji të kombinuara për të arritur cilësinë e duhur të ajrit në Komunitet dhe objektivat e lidhura me të.

(c) kapaciteti për marrjen e veprimit të mëtejshëm në nivel Komuniteti, me synim uljen e emetimeve të substancave që ndihmojnë në formimin e ozonit,

(d) ecuria në zbatimin e vlerave të synuara në Shtojcën I, duke përfshirë planet dhe programet e zhvilluara në përputhje me nenet 3 dhe 4, përvojën në zbatimin e planeve afatshkurtër sipas nenit 7 dhe kushtet e parashtruara në Shtojcën IV, sipas matjeve të kryera të cilësisë së ajrit,

(e) kapaciteti për arritjen e objektivave afatshkurtër, të përcaktuara në Seksionin III të Shtojcës I, brenda një periudhe kohore të specifikuar,

(f) kërkesat aktuale dhe të ardhshme për informimin e publikut dhe për shkëmbimin e informacionit ndërmjet Shteteve Anëtare dhe Komisionit;

(g) marrëdhënia midis Direktivës dhe ndryshimeve të pritshme që vijnë nga masat që duhet të merren nga Komuniteti dhe Shtetet Anëtare, me qëllim përmbushjen e angazhimeve në lidhje me ndryshimin e klimës;

(h) transportin e ndotjes përgjatë kufijve kombëtarë, duke marrë parasysh masat e marra në vendet candidate për anëtarësim.

3. Raporti gjithashtu përfshin një rishikim të dispozitave të kësaj Direktive, duke marrë në konsideratë rezultatet e tij, dhe, shoqërohet sipas rastit, me propozime për ndryshimin e kësaj Direktive, duke i kushtuar vëmendje të veçantë pasojave të ozonit në mjedis dhe në shëndetin e njeriut referuar veçanërisht grupeve të prekshme të popullsisë.

Neni 12

Udhëzim

1. Komisioni jep udhëzime për zbatimin e kësaj Direktive deri, më 9 shtator 2002. Në këtë drejtim, ai i referohet ekspertizës në dispozicion të Shteteve Anëtare, Agjencisë Mjedisore Evropiane dhe organeve të tjera eksperte sipas rastit, duke marrë parasysh

kërkesat ekzistuese në legjislacionin e Komunitetit dhe EMEP.

2. Udhëzimi miratohet në përputhje me procedurën e parashtruar në nenin 13 pika (2). Ky udhëzim nuk do të ketë efektin e modifikimit të vlerave të synuara, objektivave afatgjata, pragut të sinjalizimit ose pragut të informacionit, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo.

Neni 13

Procedura e Komitetit

1. Komisioni ndihmohet nga një komitet i krijuar në bazë të nenit 12 pika (2) të Direktivës 96/62/KE.

2. Kur i referohemi këtij paragrafi, zbatohen nenet 5 & 7 të Vendimit 1999/468/KE, duke marrë parasysh dispozitat e nenit 8 të tij.

Periudha e përcaktuar në nenin 5 pika (6) të Vendimit 1999/468/KE përcaktohet në tre muaj.

3. Komiteti miraton rregullat e brendshme.

Neni 14

Sanksionet

Shtetet Anëtare caktojnë sanksionet e zbatueshme për shkeljet e dispozitave të brendshme, miratuar sipas kësaj Direktive. Sanksionet do të jenë efektive, proporcionale dhe frenuese.

Neni 15

Përafrimi

1. Shtetet Anëtare sjellin në fuqi ligje, rregullore dhe dispozita administrative të nevojshme për t'u përputhur me këtë Direktivë brenda 9 shtatorit 2003. Ato informojnë menjëherë Komisionin në lidhje me këtë.

Në miratimin e këtyre masave, Shtetet Anëtare përmbajnë një referencë të kësaj Direktive ose shoqërohen nga kjo referencë me rastin e botimit të tyre zyrtar. Shtetet Anëtare vendosin për mënyrën e referimit.

2. Shtetet Anëtare i komunikojnë Komisionit tekstin e dispozitave kryesore të ligjit të brendshëm, i cili miratohet në fushën e mbuluar nga kjo Direktivë.

Neni 16

Shfuqizimi

Direktiva 92/72/KEE shfuqizohet nga data 9 shtator 2003.

Neni 17

Hyrja në fuqi

Kjo Direktivë hyn në fuqi ditën e botimit të saj në Gazetën Zyrtare të Komunitetit Evropian.

Neni 18

Të Adresuarit

Kjo Direktivë i drejtohet Shteteve Anëtare.

Hartuar në Bruksel, më 12 shkurt 2002.

Për Parlamentin Evropian

Presidenti

P. COX

Për Këshillin

Presidenti

J. PIQUÉ I CAMPS

SHTOJCA I

PËRKUFIZIMET, VLERAT E SYNUARA DHE OBJEKTIVAT AFATGJATA PËR OZONIN

I. Përkufizime

Të gjitha vlerat duhet të shprehen në $\mu\text{g}/\text{m}^3$. Volumi duhet të standardizohet në kushtet e mëposhtme të temperaturës dhe presionit: 293 K dhe 101,3 kPa. Koha duhet specifikuar në Standardet Kohore të Evropës Qendrore.

AOT40 (shprehur në $(\mu\text{g}/\text{m}^3)\cdot\text{orë}$) nënkupton shumën e ndryshimit midis përqendrimeve në orë më të mëdha se $80 \mu\text{g}/\text{m}^3$ (= 40 pjesë për miliard) dhe $80 \mu\text{g}/\text{m}^3$ gjatë një periudhe të caktuar që përdor vetëm vlerat 1 orë të matura midis orës 8:00 dhe 20:00 Kohës së Evropës Qendrore çdo ditë¹².

Me qëllim që të jenë të vlefshme, të dhënat vjetore mbi tejkalimin, të përdorura për të kontrolluar pajtueshmërinë me vlerat e synuara dhe objektivat afatgjata të mëposhtme, duhet të plotësojnë kriteret e parashtruara në Seksionin II të Shtojcës III.

	Parametri	Vlera e synuar për 2010 (a) (1)
1. Vlera e synuar për mbrojtjen e shëndetit të	Mesatarja 8-orëshe maksimale në	$120 \mu\text{g}/\text{m}^3$ nuk duhet të tejkalohe më shumë se 25

¹² ose kohën e përshtatshme për rajonet ultra-periferike

njeriut		ditë për vit kalendarik mesatarisht gjatë tre viteve (c)
2. Vlera e synuar për mbrojtjen e bimësisë	AOT40, llogaritur nga vlerat 1 h nga muaji maj deri në korrik	18 000 $\mu\text{g}/\text{m}^3 \cdot \text{h}$ mesatarisht gjatë pesë viteve(c)

II. Vlerat e synuara për ozonin

(a) Pajtueshmëria me vlerat e synuara vlerësohet si e kësaj vlere. Kjo nënkupton se viti 2010 do të jetë viti i parë, për të cilin të dhënat do të përdoren në llogaritjen e pajtueshmërisë gjatë tre ose pesë viteve të shkuara, sipas rastit.

(b) Përqendrimi mesatar, në 8-orë maksimumi në ditë, do të përzgjidhet me anë të shqyrtimit të mesatareve të njëpasnjëshme të 8 orëve, të llogaritura nga të dhënat për orë dhe të përditësuara çdo orë. Çdo mesatare në 8 orë e llogaritur në këtë mënyrë, do të caktohet ditën në të cilën mbaron. D.m.th. periudha e llogaritjes së parë për çdo një ditë do të jetë periudha nga ora 17:00 e ditës së mëparshme deri në orën 01:00 të asaj dite; periudha e fundit e llogaritjes për çdo një ditë do të jetë periudha nga ora 16:00 deri në orën 24:00 të ditës përkatëse.

(c) Nëse mesataret e tre ose pesë viteve nuk mund të vendosen mbi bazën e një grupi të plotë dhe të njëpasnjëshëm të dhënash vjetore, të dhënat vjetore minimale të kërkuara për verifikimin e pajtueshmërisë me vlerat e synuara, do të jenë si më poshtë:

— për vlerën e synuar për mbrojtjen e shëndetit të njeriut: të dhëna të vlefshme për një vit,

— për vlerën e synuar për mbrojtjen e bimësisë, të dhëna të vlefshme për tre vjet.

(1) Këto vlera të synuara dhe tejkalimi i lejuar vendosen pa cenuar rezultatet e studimeve dhe rishikimit, të parashikuara në nenin 11, që merr parasysh situatat e ndryshme gjeografike dhe klimaterike në Komunitetin Evropian.

	Parametri	Objektivi afatgjatë (a)
1. Objektivi afatgjatë për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	Mesatarja maksimale 8 orë në ditë brenda një viti kalendarik	120 $\mu\text{g}/\text{m}^3$
2 Objektivi afatgjatë për mbrojtjen e bimësisë	AOT40, llogaritur nga vlerat 1 h nga maji deri në korrik	6 000 $\mu\text{g}/\text{m}^3 \cdot \text{h}$

III. Objektivat afatgjata për ozonin

(a) Progresi i Komunitetit drejt arritjes së objektivit afatgjatë, duke përdorur si standard vitin 2020, do të rishikohet si pjesë e procesit të përcaktuar në nenin 11.

SHTOJCA II

PRAGJET E INFORMACIONIT DHE PRAGJET SINJALIZUESE

I. Pragjet e informacionit dhe pragjet sinjalizuese për ozonin

	Parametri	Pragu
Pragu i informacionit	mesatarja 1 orë	180 µg/m
Pragu i sinjalizimit	mesatarja 1 orë (a)	240 µg/m

(a) Për zbatimin e nenit 7, tejkalmi i pragut duhet të matet ose parashikohet për tre orë të njëpasnjëshme.

II. Hollësitat minimale që i duhen vënë në dispozicion publikut kur tejkalohe pragu i informacionit ose pragu sinjalizues ose parashikohet tejkalmi.

Hollësira që i duhen vënë publikut në dispozicion në një kohë sa më të shpejtë, në një shkallë mjaftueshëm të gjerë, duhet të përfshijë:

1. Informacion mbi tejkalimin(tejkalimet) e vëzhguara:

- vendndodhja ose zona e tejkalimit,
- tipi i pragut të tejkaluar (informacion ose sinjalizim),
- koha e fillimit dhe kohëzgjatja e tejkalimit,
- përqendrimi mesatar më i lartë për periudhën 1 orëshe dhe 8 orëshe;

2. Parashikim për pasditen/ditën (t) e mëposhtme:

- zona gjeografike e tejkalimeve të pritshme të informacionit dhe/ose pragut sinjalizues,
- ndryshimi i pritshëm në ndotje (përmirësimi, stabilizimi ose përkeqësimi);

3. Informacion mbi tipin e popullsisë së interesuar, pasojat e mundshme shëndetësore dhe qëndrimi i rekomanduar:

- informacion mbi grupet e popullsisë në rrezik,
- përshkrimi i simptomave të mundshme,
- masat e rekomanduara që duhen marrë nga popullsia e interesuar,
- ku të gjendet informacion i mëtejshëm;

4. Informacion mbi masat parandaluese për uljen e ndotjes dhe/ose ekspozimin ndaj saj: përcaktimi i sektorëve kryesorë burimorë; rekomandime për masa në lidhje me uljen e emetimeve.

SHTOJCA III

Informacion i paraqitur Komisionit nga Shtetet Anëtare dhe kriteret për të dhënat totale dhe llogaritja e parametrave statistikore

I. Informacioni që i duhet paraqitur Komisionit

Tabela e mëposhtme tregon tipin dhe sasinë e të dhënave që Shtetet Anëtare duhet t'i dorëzojnë Komisionit:

			Koha mesatare e grumbullimit	Të dhëna provizore për çdo muaj, nga prilli deri në shtator	
	Tipi	i	Niveli		Raporti për

	stacionit				çdo vit
Pragu i informacionit	Cilido	180 $\mu\text{g}/\text{m}^3$	1 orë	-për çdo ditë me tejkalim (e): data, orët totale të tejkalimit, maksimumi 1 orë ozoni dhe vlerat e ngjashme të NO2 kur kërkohen, -ozoni maksimal mbi baza 1 orëshe në muaj	-për çdo ditë me tejkalim (e): data, orët totale të tejkalimit, maksimumi 1 orë ozoni dhe vlerat e ngjashme të NO2 kur kërkohen,
Pragu i sinjalizimit	Cilido	240 $\mu\text{g}/\text{m}^3$	1 orë	-për çdo ditë me tejkalim (e): data, orët totale të tejkalimit, maksimumi 1 orë ozoni dhe vlerat e ngjashme të NO2 kur kërkohen,	-për çdo ditë me tejkalim (e): data, orët totale të tejkalimit, maksimumi 1 orë ozoni dhe vlerat e ngjashme të NO2 kur kërkohen,
Mbrojtja e shëndetit	Cilido	120 $\mu\text{g}/\text{m}^3$	8 orë	-për çdo ditë me tejkalim(e) data, 8 orë maksimumi (b)	-për çdo ditë me tejkalim(e) data, 8 orë maksimumi (b)
Mbrojtja e bimësisë	periferike, rurale, me origjinë rurale	AOT40 (a) = 6 000 $\mu\text{g}/\text{m}^3 \cdot \text{h}$	1 orë, grumbulluar nga muaji maj deri në korrik	-	Vlera
Mbrojtja e pyjeve	periferike, rurale, me origjinë rurale	AOT40 (a) = 20 000 $\mu\text{g}/\text{m}^3 \cdot \text{h}$	1 orë, grumbulluar nga muaji prill deri në shtator	-	Vlera
		40			

Materiale	Cilido	$\mu\text{g}/\text{m}^3$ (c)	1 vit	-	Vlera
-----------	--------	---------------------------------	-------	---	-------

- (a) shih përkufizimin AOT40 në Seksionin I të Shtojcës I.
 (b) mesatarja 8 orëve në ditë (shih seksionin II të shënimit të Shtojcës I (a)).
 (c) vlera që duhet rishikuar sipas nenit 11(3), duke marrë në konsideratë zhvillimin e dijes shkencore.

Si pjesë e raportimit vjetor, duhet të sigurohen elementët e mëposhtëm nëse të dhënat e mundshme për orë në lidhje me ozonin, dyoksidin e azotit dhe oksidet e azotit të vitit në fjalë nuk janë paraqitur sipas kuadrit të Vendimit të Këshillit 97/101/KE¹³:

- për ozonin, dyoksidin e azotit, oksidet e azotit dhe shumatat e ozonit dhe dyoksidin e azotit (shtuar si pjesë për bilion dhe shprehur në $\mu\text{g}/\text{m}^3$ ozon) maksimumi, me përqindje të përafërt 99.9th, 98th, 50th dhe mesatare vjetore dhe numri i të dhënave të vlefshme nga seritë për orë,
- maksimumi, përqindja e përafërt 98th, 50th dhe mesatare vjetore nga seritë e maksimumit të ozonit në 8 orë në ditë.

Të dhënat e paraqitura në raportet mujore vlerësohen si të përkohshme dhe nëse lind nevoja, duhen përditësuar në paraqitje të mëtejshme.

II. Kriteret për të dhënat totale dhe llogaritjen e parametrave statistikore

Përqindjet e përafërta duhet të llogariten me anë të përdorimit të metodës së specifikuar në Vendimin e Këshillit 97/101/KE.

Kriteret e mëposhtme duhet të përdoren për verifikimin e vlefshmërisë në mbledhjen e të dhënave dhe llogaritjen e parametrave statistikore:

Parametri	Raporti i kërkuar i të dhënave të vlefshme
Vlerat në 1 orë	75 % (d.m.th. 45 minuta)
Vlerat në 8 orë	75 % e vlerave (d.m.th. 6 orë)
Mesatarisht 8 orë maksimumi në ditë nga mesataret e 8 orëve të njëpasnjëshme averages	75 % e mesatares së 8 orëve të njëpasnjëshme (d.m.th mesatarisht 18 8 orë në ditë)
AOT40	90 % e vlerave të 1 ore gjatë periudhës kohore të përcaktuar për llogaritjen e vlerës AOT40 (a)
Mesatarja vjetore	75 % e vlerave të një ore gjatë verës (prill deri shtator) dhe dimër (janar deri mars, tetor deri dhjetor) në sezone më vete
Numri i tejkalimeve dhe vlerat maksimale në muaj	90 % e vlerave mesatare 8 orëshe maksimale në ditë (27 vlera ditore të mundshme në muaj) 90 % e vlerave të një ore midis orës 8:00 dhe 20:00 të Kohës së Evropës Qendrore
Numri i tejkalimeve dhe vlerat maksimale në vit	Pesë nga gjashtë muaj gjatë sezonit të verës (prill deri shtator)

- (a) në rastet kur nuk janë mundësuar të gjitha të dhënat e matura, përdoret faktori i

¹³ GZ L 35, 5.2.1997, fq. 14

mëposhtëm për llogaritjen e vlerave AOT40:

$$\text{AOT40 [estimate]} = \text{AOT40}_{\text{measured}} \times \frac{\text{total possible number of hours}}{\text{number of measured hourly values}}$$

AOT40 [preventiv]= AOT40 e matur x numrin e mundshëm total të orëve/ numrin e vlerave të matura për orë *duke qenë numri i orëve brenda periudhës kohore të përkufizimit AOT40, (d.m.th. nga ora 08:00 deri në 20:00 CET nga 1 maj deri në 31 korrik të çdo viti, për mbrojtjen e bimësisë dhe nga data 1 prill deri në 30 shtator të çdo vit për mbrojtjen e pyjeve).

SHTOJCA IV

KRITERET PËR KLASIFIKIMIN DHE VENDOSJEN E PIKAVE TË PËRZGJEDHJES SË MOSTRAVE PËR VLERËSIMET E PËRQËNDRIMEVE TË OZONIT

Konsideratat e mëposhtme do të zbatohen për matjet fikse:

I. Pozicionimi i makronivelit

Tipi i stacionit	Objektivat e matjes	Përfaqësueshmëria (a)	Kriteret e Pozicionimit të makronivelit
Urban	Mbrojtja e shëndetit të njeriut: Për vlerësimin e ekspozimit të popullsisë urbane ndaj ozonit, d.m.th ku dendësia e popullsisë dhe përqendrimi i ozonit janë relativisht të larta dhe përfaqësuese të ekspozimit të popullsisë së përgjithshme	Disa km ²	Larg nga ndikimi i emetimeve lokale si trafiku, pikat e karburantit etj; Vendet e vrimëzuara ku mund të maten nivelet e përziera mirë; Vende si zona banimi dhe zona tregtare të qyteteve, parqeve (larg nga pemët), rrugët e mëdha ose sheshet me shumë pak ose pa trafik, Zonat e hapura karakteristike të mjediseve edukuese, sportive dhe argëtuese
	Mbrojtja e shëndetit të		Në njëfarë largësie nga zona e emetimeve

Periferik	njeriut dhe e bimësisë: Për vlerësimin e ekspozimit të popullsisë dhe bimësisë të ndodhur në periferitë e grumbullimit, ku zhvillohen nivelet më të larta të ozonit ndaj të cilave popullsia dhe bimësia ka të ngjarë të ekspozohet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo	Disa dhjetëra km ²	maksimale, në drejtimin e erës duke ndjekur drejtimin kryesor të erës gjatë kushteve të favorshme për formimin e ozonit; Kur popullsia, të korrat e prekshme ose ekosistemet natyrore të vendosura në anën e jashtme të një grumbullimi ekspozohen ndaj niveleve të larta të ozonit;
			Sipas rastit, disa stacione periferike gjithashtu në zonën me drejtim të kundërt nga era të emetimeve maksimale, me qëllim vendosjen e niveleve të origjinës rajonale të ozonit
Rural	Mbrojtja e shëndetit të njeriut dhe e bibimësisë:	Nivele nënrajonale	Stacionet mund të vendosen në vendvendosje të vogla dhe/ose zona me ekosisteme natyrore, pyje ose të korra;
	Vlerësimi i ekspozimit të popullsisë, të korrat dhe ekosistemet natyrore përkundrejt përqendrimeve të ozonit në nivel nënrajonale	(disa km ²)	Përfaqësues për zonën larg nga ndikimi i emetimeve lokale si instalimet industriale dhe rrugët;
			Në zona të hapura, por jo në maja të larta malesh
Originë rurale	Mbrojtja e shëndetit të njeriut dhe e bimësisë:	Nivele rajonale/ kombëtare/kontinentale	Stacioni i vendosur në zona me popullsi më të ulët
	Vlerësimi i		Dendësia, p.sh,

	ekspozimit të të korrave dhe ekosistemeve natyrore ndaj përqendrimeve të ozonit në nivel rajonal, si dhe ekspozimit të popullsisë		ekosistemet natyrore, pyjet, larg zonave urbane dhe industriale dhe emetimeve lokale;
		(1000 deri në 10 000 km ²)	
			Shmangia e vendndodhjeve që i nënshtrohen formimit të zhvilluar në nivel lokal të kushteve të anasjellta afër nivelit të tokës, si dhe majat e maleve të larta;
			Nuk rekomandohen vende bregdetare me cikle të theksuara të përditshme ere të karakterit lokal.

(a) Pikat e përzgjedhjes së mostrave gjithashtu, sipas mundësisë, duhet të jenë përfaqësuese të vendndodhjeve të ngjashme jo në vendin më të afërt.

Për stacionet rurale dhe me origjinë rurale, sipas rastit duhet t'i kushtohet vëmendje bashkërendimit me kërkesat e vëzhgimit të Rregullores së Komisionit (KE) nr. 1091/94¹⁴ në lidhje me mbrojtjen e pyjeve të Komunitetit nga ndotja atmosferike.

II. Pozicionimi i mikronivelit

Udhëzimet e mëposhtme duhet të ndiqen në shkallën më të lartë të zbatueshme:

1. Rryma rreth sondës hyrëse të aparatit të marrjes së mostrave duhet të jetë e pakufizuar (e lirë në një hark elektrik prej të paktën 270°) pa ndonjë pengesë që cenon rrymën e ajrit në afërsi të aparatit të marrjes së mostrave, d.m.th larg ndërtesave, ballkoneve, pemëve dhe pengesave të tjera prej më shumë se dyfishi i lartësisë ku pengesa ndërhyr mbi aparatit të marrjes së mostrave.

2. Në përgjithësi, pika e hyrjes së marrjes së mostrave duhet të jetë midis 1.5 m (zona e frymëmarrjes) dhe 4 m lart nivelit të tokës. Pozicione më të larta janë të mundshme për stacionet urbane në disa rrethana dhe në zonat e pyllëzuara.

3. Sonda hyrëse duhet të pozicionohet larg këtyre burimeve si furra dhe vrima oxhaku djegieje dhe më shumë se 10 m nga rruga më e afërt, me largësi në rritje për shkak të dendësisë së trafikut.

¹⁴ GZ L 125, 18.5.1994, fq. 1.

4. Dalja e tubit të shkarkimit të aparatit të marrjes së mostrave duhet të pozicionohet në mënyrë që të shmanget riqarkullimi i hyrjes së aparatit të marrjes së mostrave të ajrit të tubave të shkarkimit. Mund të merren parasysh edhe faktorët e mëposhtëm:

- a) burimet ndërhyrëse;
- b) siguria;
- c) mundësia e hyrjes;
- d) vënia në dispozicion e energjisë elektrike dhe komunikimit telefonik;
- e) dukshmëria e vendit në lidhje me ambientet rrethuese;
- f) siguria e publikut dhe e operatorëve;
- g) preference e bashkëvendosjes së pikës së përzgjedhjes së mostrave për ndotës të ndryshëm;
- i) kërkesat e planifikimit.

III. Dokumentacioni dhe rishikimi i përzgjedhjes së vendit

Procedurat e përzgjedhjes së vendit duhet të jenë tërësisht të dokumentuara në fazën e klasifikimit me mjete të tilla si fotografi speciale të mjediseve rrethuese dhe një hartë e detajuar. Vendet duhet të rishikohen në intervale të rregullta kohore me dokumentacion të përsëritur, për të siguruar plotësimin e kriterëve të përzgjedhjes.

Kjo kërkon projektim dhe interpretim të të dhënave monitoruese në kontekstin e proceseve meteorologjike dhe fotokimike që cenojnë përqendrimit e ozonit të matura në vendin përkatës.

SHTOJCA V

KRITERET PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT MINIMAL TË PIKAVE TË PËRZGJEDHJEVE TË MOSTRAVE PËR MATJET FIKSE TË PËRQËNDRIMEVE TË OZONIT

I. Numri më i vogël i pikave të përzgjedhjes së mostrave për matjet e vazhdueshme fikse për vlerësimin e cilësisë së ajrit, me synim pajtueshmërinë me vlerat e synuara, objektivat afatgjata dhe informacionin dhe pragjet sinjalizuese, ku matja e vazhdueshme është burimi i vetëm i informacionit

Popullsia (× 1000)	Grumbullimet (urbane dhe periferike) (a)	Zona të tjera (periferike dhe rurale) (a)	Origjina rurale
< 250		1	1 stacion/50 000 km ² si dendësi mesatare në të gjitha zonat për vend (b)
< 500	1	2	
< 1 000	2	2	
< 1 500	3	3	
< 2 000	3	4	
< 2 750	4	5	
< 3 750	5	6	
> 3 750	1 stacion shtesë për 2 milion banorë	1 stacion shtesë për 2 milion banorë	

(a) Të paktën 1 stacion në zonat periferike, ku ka të ngjarë të ndodhë ekspozimi më i

lartë i popullsisë. Në grumbullime të paktën 50 % të stacioneve duhet të vendosen në zonat periferike.

(b) Rekomandohet 1 stacion për 25 000 km² për terrene komplekse.

II. Numri më i vogël i pikave të përzgjedhjes së mostrave për matjet fikse në lidhje me zonat dhe qendrat e banimit që arrijnë objektivat afatgjata

Numri i pikave të përzgjedhjes së mostrave për ozonin, në ndërthurje me mjete të tjera të vlerësimit plotësues si modelimi i cilësisë së ajrit dhe matjet e rregulluara të dyoksidit të azotit duhet të jenë të mjaftueshme për të shqyrtuar tendencën e ndotjes së ozonit dhe vërtetimin e pajtueshmërisë me objektivat afatgjata. Numri i stacioneve të vendosura në grumbullime dhe në zona të tjera mund të ulet në një të tretën e numrit të specifikuar në Seksionin I. Kur informacioni nga stacionet e matjeve fikse është burimi i vetëm i informacionit, duhet të ruhet të paktën një stacion monitorues.

Nëse, në zonat ku ka vlerësim plotësues, rezultati i kësaj është që një zonë nuk ka stacion tjetër që mbetet, bashkërendimi me numrin e stacioneve në zonat fqinje duhet të sigurojë vlerësimin e mjaftueshëm të përqendrimeve të ozonit kundrejt objektivave afatgjata. Numri i stacioneve me origjinë rurale duhet të jetë 1 për 100 000 km².

-

SHTOJCA VI

MATJET E SUBSTANCAVE QË NDIHMOJNË NË FORMIMIN E OZONIT

Objektivat

Objektivat kryesore të këtyre matjeve janë analizimi i çdo tendence në substanca që ndihmojnë në formimin e ozonit, për kontrollin e efektivitetit të strategjive për uljen e emetimeve, për kontrollin e qëndrueshmërisë së inventarëve të emetimeve dhe për të nxitur atribuimin e burimeve të emetimeve përqendrimit të ndotjes.

Një qëllim tjetër është mbështetja e perceptimit të formimit të ozonit dhe proceseve të shpërndarjes së substancave që ndihmojnë në formimin e ozonit, si dhe zbatimi i modeleve fotokimike.

Substancat

Matjet e substancave që ndihmojnë në formimin e ozonit duhet të përfshijnë të paktën oksidet e azotit dhe përbërësit e përshtatshëm organikë të avullueshëm (VOC). Një listë e përbërësve organikë të avullueshëm që rekomandohet për matjet, jepet më poshtë.

	1 Buten	Izopren	benzol etilik
Etan	trans-2-Buten	n- Heksan	m+p-ksilen
Etilen	cis-2-Buten	i-Heksan	o-ksilen
Acetilen	1.3-Butadien	n-Heptan	1,2,4-benzol trimeth.
Propan	n-Pentan	n-Oktan	1,2,3- benzol trimeth.
Propen	i-Pentan	i-Oktan	1,3,5- benzol trimeth.
n-Butan	1-Penten	Benzol	Formaldehid
i-Butan	2-Penten	Toluen	Hidrokarbure totale pa përmbajtje metani

Metodat e referencës

Metoda e referencës e specifikuar në Direktivën 1999/30/KE¹⁵ ose në legjislacionin e mëtejshëm të Komunitetit zbatohet për oksidet e azotit.

Çdo Shtet Anëtar duhet të informojë Komisionin në lidhje me metodat që përdor për marrjen e mostrave dhe matjet VOC.

Komisioni duhet të bëjë ushtrime ndërkrahasuese në një kohë sa më të shpejtë dhe të eksplorojë mundësinë e përcaktimit të metodave të referencës për marrjen e mostrave dhe matjet e substancave që ndihmojnë në formimin e ozonit, me qëllim përmirësimin e krahasueshmërisë dhe saktësisë së matjeve për rishikimin e kësaj Direktive në përputhje me nenin 11.

Vendet

Matjet duhet të bëhen veçanërisht në zonat urbane dhe periferike në çdo vend vëzhgimi të krijuar në përputhje me kërkesat e Direktivës 96/62/KE dhe të konsideruar si të përshtatshme në lidhje me objektivat e mësipërme vëzhguese.

SHTOJCA VII

OBJEKTIVAT E CILËSISË SË TË DHËNAVE DHE PËRGATITJA E REZULTATEVE TË VLERËSIMIT TË CILËSISË SË AJRIT

I. Objektivat e cilësisë së të dhënave

Objektivat e mëposhtme të cilësisë së të dhënave për pasigurinë e lejuar të metodave të vlerësimit dhe mbulimi minimal i kohës dhe përfundimit të të dhënave në matjet që jepen si udhëzime për programet e sigurimit të cilësisë.

	Për ozonin, NO dhe NO ₂
Masa të vazhdueshme fikse	
Pasiguria e matjeve individuale	15%
Përfundimi i të dhënave minimale	90 % gjatë verës
	75 % gjatë dimrit
Matjet treguese	
Pasiguria e matjeve individuale	30%
Përfundimi i të dhënave minimale	90%
Mbulimi minimal i kohës	> 10 % gjatë verës
Modelimi	
Pasiguria	
Mesataret për 1 orë (gjatë ditës)	50%
Maksimu i 8 orëve në ditë	50%
Vlerësimi objektiv	
Pasiguria	75%

Pasiguria (në një interval besueshmërie prej 95%) e metodave të matjeve do të vlerësohet në përputhje me parimet e ISO 'Udhëzim për Shprehjen e Pasigurisë në

¹⁵ GZ L 163, 29.6.1999, fq. 41.

Matje' (1993), ose metodologjisë së ISO 5725-1 'Saktësia (vërtetësia dhe saktësia) e metodave dhe rezultateve të matjeve (1994) ose elemente të barasvlershme me to. Përqindjet për pasigurinë në tabelë jepen për masa individuale, të marra mesatarisht gjatë periudhës për llogaritjen e vlerave të synuara dhe objektivave afatgjata, për një interval besueshmërie prej 95 %. Pasiguria për matjet e vazhdueshme fikse duhet të interpretohet si e zbatueshme në rajonin e përqendrimit të përdorur për pragun e përshtatshëm.

Pasiguria për modelimin dhe vlerësimin objektiv përcaktohen si devijime maksimale të niveleve të matura dhe llogaritja të përqendrimit gjatë periudhës për llogaritjen e pragut të përshtatshëm, pa marrë parasysh kohëzgjatjen e ngjarjeve.

'Mbulimi kohor' përcaktohet si përqindja e kohës së marrë në konsideratë për vendosjen e vlerës së pragut gjatë së cilës matet ndotësi.

'Përftimi i të dhënave' përcaktohet si raporti i kohës për të cilën procedurat e instrumentit nxjerrin të dhëna të vlefshme, me kohën për të cilën duhet llogaritur vlera totale ose parametri statistikor.

Kërkesat për minimum përftimi të dhënash dhe mbulimi kohor nuk përfshijnë humbjet e të dhënave për shkak të kalibrimit të rregullt ose ruajtjes normale të pajisjeve të përdorura.

II. Rezultatet e vlerësimit të cilësisë së ajrit

Informacioni i mëposhtëm duhet të përgatitet për zonat ose grumbullimet brenda të cilave, janë përdorur burime të ndryshme nga matjet për plotësimin e informacionit nga matjet:

- përshkrimi i aktiviteteve të kryera të vlerësimit,
- metodat e veçanta të përdorura, me referenca ndaj përshkrimeve të metodës,
- burimet e të dhënave dhe informacioni,
- një përshkrim të rezultateve, duke përfshirë pasiguritë dhe veçanërisht, shkallën e çdo zone brenda zonës ose grumbullimit mbi të cilin përqendrimet tejkalojnë objektivat afatgjata ose vlerat e synuara,
- për objektiva afatgjata ose vlera të synuara, objekti i të cilave është mbrojtja e shëndetit të njeriut, popullsia që ka të ngjarë të ekspozohet ndaj përqendrimeve që tejkalojnë pragun.

Kur është e mundur, Shtetet Anëtare duhet të përgatisin harta që tregojnë shpërndarjet e përqendrimeve brenda secilës zonë ose grumbullim.

III. Standardizimi

Për ozonin, volumi duhet standardizuar në kushtet e mëposhtme në temperaturën dhe presionin: 293 K, 101,3 kPa.

Për oksidet e azotit, zbatohet standardizimi i specifikuar në Direktivën 1999/30/KE.

SHTOJCA VIII

METODA E REFERENCËS PËR ANALIZËN E OZONIT DHE KALIBRIMIN E INSTRUMENTAVE NË LIDHJE ME OZONIN

I. Metoda e referencës për analizën e ozonit dhe kalibrimin e instrumenteve në lidhje me ozonin

— metoda e analizës: metoda fotometrike UV (ISO FDIS 13964),

— metoda e kalibrimit: Fotometër reference UV (ISO FDIS 13964, VDI 2468, B1.6).

Kjo metodë standardizohet nga Komiteti Evropian për Standardizimin (CEN). Sapo ky i fundit të ketë publikuar standardin përkatës, metodat dhe teknikat e përshkruara në të, do të përbëjnë metodën referuese dhe të kalibrimit në këtë Direktivë.

Një Shtet Anëtar gjithashtu mund të përdorë çdo metodë tjetër që mund të provojë se jep rezultate të barasvlershme me metodën e mësipërme.

Teknika e referencës së modelimit për ozonin

Teknikat e referencës së modelimit për ozonin nuk mund të specifikohen aktualisht.

Çdo ndryshim për përshtatjen e kësaj pike ndaj progresit shkencor dhe teknik do të miratohet në përputhje me procedurën e parashtruar në nenin 13(2).